

## AMENDAMENTIMI NR 2

### I MARRËVESHJES FINANCIARE

për

#### Programin e Veprimit për Kosovën\* për vitin 2016 – Pjesa I

Siç është përfunduar fillimisht ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës më 27 tetor 2017, dhe siç është modifikuar më 26 janar 2022 përmes Amendamentimit nr. 1, më poshtë referuar si "Marrëveshja Financiare".

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni", duke vepruar në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "Unioni",

nga njëra pjesë, dhe

Kosova, në vijim referuar si "përfituese e IPA II", e përfaqësuar nga Zyra e Kryeministrit nga pjesa tjetër,

së bashku të referuara më tej si "palët",

Ndërsa,

- (1) Komisioni ka miratuar më 06.12.2016 një Vendim Zbatues të Komisionit C(2016) 8261 për krijimin e një Programi të Veprimit për Kosovën për vitin 2016 - Pjesa I. Ky Program zbatohet me anë të Marrëveshjes Financiare të lidhur ndërmjet Kosovës dhe Komisionit më 27.10.2017.
- (2) Komisioni e ka parë të nevojshme ndryshimin e Marrëveshjes Financiare.
- (3) Ky ndryshim synon të zgjasë datën e përfundimit të periudhës së zbatimit si dhe datën e përfundimit të periudhës së ekzekutimit për dy vjet.
- (4) Programi i Veprimit për Kosovën për vitin 2016 – Pjesa I është modifikuar në mënyrë që të reflektojë ndryshimet e kërkuara dhe për këtë arsye është e nevojshme që Marrëveshja Financiare të jetë në përputhje me Programin e ndryshuar.

JANË PAJTUAR PËR MË POSHTË:

#### Neni 1

1. Neni 2 i Kushteve të Veçanta të Marrëveshjes Financiare zëvendësohet si vijon:

*"Neni 2 – Periudha e ekzekutimit dhe periudha operative e zbatimit*

*(1) Perindlia e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financiare siç përcaktohet në nenin 12 të Shtojcës II (Kushtet e Përgjithshme) është fiksuar në katërbëdhjetë (14) vjet, nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financiare.*

*(2) Kohëzgjatja e periudhës së zbatimit operacionul, siç përcaktohet në nenin 12 të Shtojcës II (Kushtet e Përgjithshme) caktohet në nëntë (9) vjet, nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financiare.”*

2. Shtojca I e Marrëveshjes Financiare zëvendësohet me Shtojcën I të kësaj Shtese.

## Neni 2

Të gjitha termat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes Financiare mbeten të pandryshuara.

## Neni 3

Ky amendamentim do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Komisioni merr një njoftim nga përfituesi i IPA II që konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit të IPA II të nevojshme për hyrjen e tij në fuqi. Komisioni do të informojë përfituesin IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi. Ky amendamentim do të jetë pjesë përbërëse e Marrëveshjes Financiare.

Amendamenti nr. 2 i Marrëveshjes Financiare është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze, një i dorëzohet Komisionit dhe një përfituesi i IPA II.

Për përfituesin e IPA II:

Për komisionin:

Data

Data

Z. Besnik Bislimi  
Zëvendëskryeministri i parë për Integritet  
Evropian, Zhvillim dhe Dialog  
Zyra e Kryeministrit  
10000 Prishtinë, Kosovë

Znj. Valentina SUPERTI  
Drejtor NEAR D – Ballkani Perëndimor  
DP Fqinjësia dhe Negociatat e Zgjerimit  
Komisioni Evropian  
B-1049 Bruksel, Belgjikë

SHTOJCA I

PROGRAMI I VEPRIMIT PËR KOSOVËN \* PËR VITIN 2016 – PJESA I

I IDENTIFIKIMI

Përfituesi	Kosova
Referencat e zotimeve në CRIS/ABAC	2016/039 744 / EUR 18 500 000 - 22.02 01 01 2016/039 745 / EUR 27 000 000 - 22.02 01 02
Kostoja totale	71 150 000 EUR
Kontributi i BE-së	45 500 000 EUR
Linjat buxhetore	22.02 01 01 dhe 22.02 01 02
Mënyra e menaxhimit / Strukturat Përgjegjëse	Menaxhimi i drejtpërdrejt nga Komisioni Evropian Menaxhimi indirekt nga strukturat përgjegjëse të radhitura më poshtë: Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM) për Veprimin 3: Mbështetje për të Drejtat e Komuniteteve në Kosovë; Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për Veprimin 4: Mbështetje për Përmirësimin e Konkurrencshmërisë në Kosovë.
Data e fundit për arritjen e <u>Marrëveshjes për Financim me përfituesin e IPA II</u>	Më së voni deri më 31 dhjetor 2017
Data finale për arritjen e <u>marrëveshjeve për delegim nën menaxhim indirekt</u>	Më së voni deri më 31 dhjetor 2017
Data përfundimtare për <u>lidhjen e kontratave të prokurimit dhe granteve</u>	3 vite pas datës së arritjes së Marrëveshjes për Financim me përjashtim të rasteve të renditura në Nenin 189(2) të Rregullores për Financim
Data përfundimtare për zbatimin operacional	9 vite pas datës së arritjes së Marrëveshjes për Financim.
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes për Financim	14 vite pas përfundimit të Marrëveshjes për Financim.
Njësia e programimit	NEAR D3 Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosovë

\* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB dhe Opinionin e GjKND-së mbi shpalljen e Pavarësisë së Kosovës

Njësia e zbatimit/ Delegacioni i BE-së	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
---	-------------------------------------

## 2 PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË VEPRIMIT

### 2.1 SEKTORËT E PËRZGJEDHUR NË KUADËR TË KËTIJ PROGRAMI TË VEPRIMIT

- **Arsyefimi për përzgjedhjen e sektorëve të veçantë në kuadër të këtij programi:**

Në kuadër të Programit të Veprimit për Kosovën për vitin 2016 - Pjesa I, do të mbështeten sektorët në vijim: demokracia dhe qeverisja, sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore, konkurrueshmëria dhe inovacioni, arsimi, punësimi dhe politikat sociale.

Qëllimi kryesor i veprimit në kuadër të demokracisë dhe qeverisjes është të mbështesë më tej integrimin e Kosovës në ekonominë globale dhe fuqizimi i rolit të administratës së Kosovës në promovimin e zhvillimit socio - ekonomik në tregti, lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve dhe fuqizimin e përafrimit sektorial në harmoni me obligimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Fokus i veçantë do t'i jepet përpjekjeve për fuqizimin e kapacitetit teknik dhe administrativ të administratës së Kosovës në lidhje me agjendën Evropiane të Kosovës dhe në mbështetjen e menaxhimit dhe absorbimit efektiv dhe efikas të fondeve të IPA. Programi gjithashtu do të mbështesë zbatimin e dialogut të ndërmjetësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe rritjen e efikasitetit, pavarësisë dhe llogaridhënies së shoqërisë civile në pjesëmarrjen e saj në procesin e politikë-bërjes.

Veprimi në kuadër të sektorit të sundimit të ligjit dhe të drejtave themelore do të kontribuojë në një shoqëri të qëndrueshme shumetnike në Kosovë duke mundësuar jetesë të qëndrueshme dhe integrim të qëndrueshëm të personave të zhvendosur në shoqërinë Kosovare. Kjo përfshinë Personat e Zhvendosur Brenda Vendit (PZHBV-të), Personat e Zhvendosur në Rajon (PZHR-të) dhe refugjatët siç përcaktohen në Strategjinë e Kosovës për Komunitete dhe Kthim (2014-2018). Ky veprim në mënyrë specifike synon rritjen e kapaciteteve të akterëve publik dhe jo-qeveritarë në të gjitha nivelet për të lehtësuar kthimin dhe riintegrimin e dinjitetshëm dhe të qëndrueshëm, në Kosovë, të deri në 400 familjeve të zhvendosura në rajon, përfshirë familjet Rome, Ashkali dhe Egjiptas në vendbanimet dhe kampet jo-formale në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Mal të Zi.

Qëllimi kryesor i veprimit në kuadër të konkurrueshmërisë dhe inovacionit është rritja e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë (NMVM-ve) duke ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë financiare dhe teknike. Mbështetja do të ofrohet nëpërmjet granteve dhe lehtësive kreditore për përzierjen e fondeve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me fondet e IPA në mënyrë që të lehtësohet qasja në

financa për projektet zhvillimore të ndërmarrjeve në Kosovë që kanë potencial për promovimin e eksportit, zëvendësimin e importit dhe krijimin e vendeve të punës.

Veprimi në sektorin e arsimit, punësimit dhe politikave sociale ka për qëllim përmirësimin e regjistrimit dhe përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit parashkollor dhe fillor sipas Planit të ri Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017 – 2021. Gjithashtu duhet të nxisë reforma në administratën publike që do të qojnë në zbatimin e politikave arsimore, të punësimit dhe atyre sociale në harmoni me MSA-në. Veprimi gjithashtu synon rritjen e punësimit formal dhe përfshirjen sociale në Kosovë përmes targetimit të të rinjve dhe grave dhe përmes fuqizimit të kapacitetit njerëzor të institucioneve përfituese në mënyrë që të reduktohet puma e padeklaruar dhe të rritet punësimi dhe perspektivat për punësim të qëndrueshëm për grupet e pafavorizuara.

- **Përmbledhje veprimesh të kaluara dhe në vazhdim e sipër të BE-së, donatorëve të tjerë dhe/ose përfituesve të IPA II në sektorët relevant:**

Veprimet nën secilin sektor janë ndërtuar bazuar në asistencën e ofruar në të kaluarën nga BE-ja përmes IPA I dhe IPA II 2014 dhe 2015: mësimet e nxjerra nga vlerësimet dhe auditimet e kaluara janë marrë në konsideratë gjatë projektimit të këtyre veprimeve, si dhe plotësueshmëria me veprime të financuara nga donatorët tjerë.

Në sektorin e demokracisë dhe qeverisjes, asistenca e mëparshme ka qenë e fokusuar në fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës, përfshirë kuvendin, në transpozimin, aplikimin dhe zbatimin e acquis të BE-së, veçanërisht në fushat e mbuluara në Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit. Për më tepër, mbështetja është ofruar për menaxhimin dhe absorbimin efektiv dhe efikas të fondeve të IPA-s, zbatimin e dialogut të ndërmjetësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe rritjet në efikasitetin, pavarësinë dhe llogaridhënien e shërbimit civil të Kosovës. Skema e Profesionistëve të Rinj (The Young Cell Scheme (YCS)), e iniciuar në vitin 2004, ka përfshirë nëntë runde të përzgjedhjes së studentëve. Gjithsej 246 grante janë dhënë nën YCS që nga fillimi i saj dhe përfituesit e këtyre granteve janë regjistruar në programet master në vende të ndryshme të BE-së (Belgjikë, Holandë, Itali, Portugali, Estonia, Letoni, Mbretëri e Bashkuar, Gjermani, Austri, Francë dhe Hungari) dhe në fusha të ndryshme duke filluar nga e drejta e BE-së dhe ekonomia e deri tek çështjet Evropiane dhe politikat publike, shkencat mjedisore, studimet bujqësore, statistikat, siguri dhe rregulla të aviacionit, inxhinieri, telekomunikacion, siguri të ushqimit, etj.

Asistenca në kuadër të sundimit të ligjit dhe të drejtave themelore ka adresuar sfidat në nën-sektorët e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Në drejtësi, asistenca e BE-së ka qenë e fokusuar në ofrimin e sistemit të dhënave penale, reformimin e kornizës rregullative mbi të drejtat e pronës, fuqizimin e kornizës së sistemit penitenciar, përmirësimin e shërbimeve, korrektuese, provuese dhe mjekësisë ligjore, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Mbështetja gjithashtu është ofruar në fuqizimin e edukimit ligjor për rritjen e shkallës së profesionalizimit, llogaridhënies dhe efikasitetit të gjyqësorit.

Në kuadër të nën-sektorit "punët e brendshme" fokusi ka qenë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve ligj zbatuese dhe ato në sundim të ligjit në ofrimin nga ata të shërbimeve në nën-sektorin e drejtësisë dhe shoqërinë Kosovare në përgjithësi. Aktivitetet e synuara për fuqizimin e strukturave që merren me migracionin në harmoni me pikat përkatëse referuese të udhërrëfyesit për viza dhe fuqizimi i institucioneve që luftojnë trafikimin me qenie njerëzore.

Asistenca paraprake në kuadër të konkurrueshmërisë dhe inovacionit ka synuar përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit privat, në veçanti nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës komunale dhe performancës së kompanive Kosovare me qëllim të rritjes së eksporteve të produkteve dhe shërbimeve. Asistenca gjithashtu ka synuar NVM-të e Kosovës në rritjen e performancës, prodhimit, kapaciteteve të eksportit dhe punësimit përmes ofrimit të qasjes alternative në financa. Përveç kësaj, mbështetja është ofruar në fuqizimin e politikës tregtare të Kosovës përmes përmirësimit të lehtësimit tregtar dhe ekspertizës negociuese në kuadër të shërbimit civil dhe reduktimit të deficitit tregtar përmes rritjes së eksporteve të produkteve dhe shërbimeve.

Veprimet në kuadër të programeve paraprake në sektorin e arsimit, punësimit dhe politikave sociale që kanë synuar përmirësimin e nivelit të arsimit dhe punësimit të të rinjve në Kosovë përmes promovimit të iniciativës rajonale në arsimin dhe aftësimin profesional në nivel më të lartë në përputhje me nevojat e tregut të punës përderisa dhe njëkohësisht në ndërtimin e raporteve ndërmjet komunitetin dhe promovimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm shumëpartak. Për më tepër, Kosova është mbështetur në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të arsimit dhe aftësimit përmes integritit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përmirësuar në këtë mënyrë mësimin gjatë gjithë jetës dhe perspektivat e punësimit. Asistenca e BE-së ka kontribuar në zvogëlimin e varfërisë nëpërmjet përmirësimit të mundësive ekonomike për popullsinë e Kosovës, veçanërisht për grupet më të marginalizuara (arritjen e përfaqësimit të duhur të minoriteteve në aftësim dhe këshillim, promovimin e rekrutimit dhe përfaqësimit të duhur të minoriteteve në shërbimin civil, administratë qendrore dhe lokale dhe plotësimin e nevojave të veçanta të komuniteteve Serbe, Rome, Ashkali, Egjiptase dhe tjera).

*Lista e veprimeve të parapara nën sektorët/prioritetet e përzgjedhura:*

**Demokracia dhe Qeverisja**

MENAXHIMI I DREJTPËRDREJTË	
Veprimi 1 "Lehtësimi i përafrimit me Acquis të BE "	7 500 000 EUR
Veprimi 2 "Lehtësimi jetësimit të prioriteteve politike, duke përfshirë dialogun e ndërmjetësuar nga Be për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës"	3 000 000 EUR
GJITHSEJ	10 500 000 EUR

**Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore**

MENAXHIMI INDIREKT ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE	
Veprimi 3 "Mbështetje për të drejtat e komuniteteve në Kosovë "	8 000 000 EUR
GJITHSEJ	8 000 000 EUR

**Konkurrueshmëria dhe inovacioni**

MENAXHIMI I DREJTPËRDREJTË		MARRËVESHJET TJERA ZBATUESE	
Veprimi 4 "Mbështetje në përmirësimin e konkurrueshmërisë së Kosovës"	5 000 000 EUR	Menaxhimi indirekt me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	5 000 000 EUR
GJITHSEJ	5 000 000 EUR	GJITHSEJ	5 000 000 EUR

**Arsimi, punësimi dhe politikat sociale**

MENAXHIMI I DREJTPËRDREJTË	
Veprimi 5 "Mbështetje për arsimin në Kosovë "	9 000 000 EUR
Veprimi 6 "Zbatimi i Masave Aktive të Tregut të Punës dhe Mbështetja në Luftën kundër Punës së Padeklaruar"	8 000 000 EUR
GJITHSEJ	17 000 000 EUR



## 2.2 PËRSHKRIMI DHE IMPLEMENTIMI I VEPRIMEVE

<b>SEKTORI 1</b>	<b>Demokracia dhe Qeverisja</b>		<b>10 500 000 Euro</b>
<b>Veprimi 1</b>	<b>Lehtësimi i përafrimit me Acquis të BE</b>	<b>Menaxhimi i drejtpërdrejtë</b>	<b>7 500 000 Euro</b>

### *(1) Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës*

Qëllimi kryesor i këtij veprimi është që të mbështesë më tej integrimin e Kosovës në ekonominë globale dhe të fuqizojë rolin e administratës së Kosovës në promovimin e zhvillimit socio-ekonomik në tregti, lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve dhe fuqizimin e përafrimit sektorial nëpërmjet funksioneve efikase rregullative në harmoni me obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilitetit dhe Asociimit. Përveç kësaj, ky lehtësim synon të fuqizojë kapacitetin teknik dhe administrativ të administratës në lidhje me Agjendën e Evropiane të Reformave në Kosovë dhe të mbështesë menaxhimin dhe absorbimin efektiv dhe efikas të fondeve të IPA-s.

Rezultatet e pritura:

- Kapaciteti i Qeverisë së Kosovës për zhvillimin, negocimin dhe zbatimin e politikave tregtare, me fokus të veçantë në mbrojtjen dhe zbatimin e pronësisë intelektuale. Në harmoni me kërkesat ndërkombëtare tregtare dhe praktikat e BE-së, kapaciteti i Kosovës për mbështetjen e tregtarëve të saj do të përmirësohet;
- Legjislacioni i Kosovës në fushat e infrastrukturës së cilësisë, mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit përafrohet më tej me acquis të BE-së dhe institucionet përgjegjëse për infrastrukturën e cilësisë, mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut janë në gjendje të zbatojnë legjislacionin në tregun e brendshëm të Kosovës;
- Direktiva e BE-së për Shërbimet (Direktiva 2006/123/EC) është transpozuar në mënyrë efikase dhe të plotë dhe zbatohet në tregun e brendshëm të Kosovës;
- Reagime mirë të koordinuara me qëllim përmbushjen e nevojave specifike dhe urgjente në lidhje me reformat Evropiane të Kosovës dhe për zbatimin e fondeve të IPA-s.

Treguesit kyç:

- Legjislacioni i Kosovës i harmonizuar më tej me acquis të BE-së në harmoni me qasjen e rregullimit më të mirë dhe Kosova mund të tregojë progres në zbatimin e saj;
- Indeksi i mbulimit të eksportit - importit (%) është përmirësuar,

### *(2) Supozimet dhe kushtet*

Duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme nëse synohet arritja e rezultateve të mësipërme indikative: angazhimi politik në procesin e reformës; angazhimi i stafit në ministrinë përkatëse; angazhimi i të gjithë akterëve në qasjen për rregullim më të mirë, alokimi i resurseve adekuate. Dështimi në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara më lartë mund të shpie në kthimin e fondeve në bazë të këtij programi dhe/ose ri-alokimin e fondeve në të ardhmen.

### *(3) Marrëveshja për zbatimin e Veprimit: menaxhimi i drejtpërdrejtë*

#### *Elementet thelbësore të veprimit*

Varësisht nga nevojat në lidhje me rrugën Evropiane të Kosovës, masat e përshkruara më lartë do të zbatohen nëpërmjet një sërë kontratash/kornizë të shërbimit, si dhe kontratat e punimeve dhe furnizimit ku nevoja për reagim të shpejtë të Komisionit Evropian ndaj ngjarjeve jo të programuara është e tillë që kohëzgjatja e procedurës për ndryshimin e këtij vendimi do të mund të pengonte qëllimin e reagimit të fillë. Zbatimi do të përfshijë:

**Prokurimin:** Ndarja e përgjithshme buxhetore e rezervuar për prokurim: 6,250,000 EUR

Numri i indikatorit dhe lloji i kontratave: 3 – 6 kontrata të shërbimit, 3-5 kontrata kornizë dhe 2-3 kontrata të furnizimit apo punës.

Afati kohor i indikatorit për iniciimin e procedurës së prokurimit: TM3 2016 – TM1 2018

**Granti – Binjakëzimi – Thirrja për propozim:** Binjakëzimi; Direktiva e BE-së për Shërbimet

- Objektivat dhe rezultatet e parapara: Ngritja e kapacitetit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për transpozimin dhe zbatimin efikas të Direktivës së BE-së për Shërbime në tregun e brendshëm në Kosovë (Direktiva 2006/123/EC);
- Kriteret thelbësore të kualifikimit: aplikantët duhet të jenë nga administratat e shteteve anëtare të BE-së apo organe të mandatuara;
- Kriteri thelbësor i përzgjedhjes është kapaciteti operacional i aplikuesit;

- d) Kriteret thelbësore të aprovimit të propozimit janë ekspertiza teknike e aplikuesit dhe ndërlidhja, metodologjia dhe qëndrueshmëria e veprimit të propozuar;
- e) Norma maksimale e bashkë-financimit nga BE: Norma maksimale e financimit nga BE mund të jetë deri në 100% të kostos së përgjithshme të veprimit në përputhje me nenin 192 të Rregullores Financiare, nëse financimi i plotë është thelbësor për realizimin e veprimit. Nevoja për financim të plotë nga BE arsyetohet nga zyrtari i autorizuar përgjegjës për aprovimin e propozimit, në lidhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar;
- f) Shuma indikative e kontratës së binjakëzimit: 1.0 milion EUR;
- g) Data indikative për lansimin e procedurës së përzgjedhjes: TM2 2017.

**Grant – Binjakëzim – Thirrje për propozim: Twinning light: Përafrimi me Acquis të BE**

- a) Objektivat dhe rezultatet e parapara: Përafrimi me Acquis të BE në harmoni me obligimet që dalin nga MSA;
- b) Kriteret thelbësore të kualifikimit: aplikantët duhet të jenë nga administratat e shteteve anëtare të BE-së apo organet e mandatuara;
- c) Kriteri thelbësor i përzgjedhjes është kapaciteti operativ i aplikantit;
- d) Kriteret thelbësore të aprovimit të propozimit janë ekspertiza teknike e aplikantit dhe rëndësia, metodologjia dhe qëndrueshmëria e veprimit të propozuar;
- e) Norma maksimale e bashkë-financimit të BE-së: Norma maksimale e mundshme e financimit nga ana e BE-së mund të jetë deri në 100% të kostos totale të veprimit në përputhje me nenin 192 të Rregullores Financiare, nëse financimi i plotë është thelbësor për kryerjen e veprimit. Nevoja për financim të plotë të BE-së do të arsyetohet nga zyrtari i autorizuar përgjegjës për aprovimin e propozimit, në lidhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar;
- f) Shuma indikative e kontratës së binjakëzimit: 0.25 milionë Euro;
- g) Data indikative për fillimin e procedurës së përzgjedhjes: TM3 2017.

<b>SEKTORI</b> <b>1</b>	<b>Demokracia dhe qeverisja</b>		<b>10 500 000 Euro</b>
<b>Veprimi 2</b>	<b>Lehtësim në jetësimin e prioritetive</b>	<b>Menaxhimi i drejtpërdrejtë</b>	<b>3 000 000 Euro</b>

	<p>politike, duke përfshirë dialogun e ndërmjetësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës</p>		
--	--	--	--

*(1) Përshkrimi i Veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës*

Objektivi kryesor i këtij veprimi është mbështetja e institucioneve të Kosovës në zbatimin e masave që lidhen me prioritetet urgjente politike në mbështetje të perspektivës evropiane të Kosovës, duke përfshirë edhe ato çështje që mund të lindin nga dialogu i ndërmjetësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë, mandati i EULEX-it ( në funksion të bartjes graduale të përgjegjësiave tek autoritetet relevante si dhe fuqizimin e pronësisë së tyre), liberalizimi i vizave dhe zhvillimet tjera politike.

Rezultatet e pritura përfshijnë si në vijim: marrëdhëniet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit janë përmirësuar; është arritur progres në integrimin e Kosovës veriore dhe është rritur besimi i ndërsjellë ndërmjet komuniteteve; dhe kapacitetet e autoriteteve të Kosovës për marrjen e përgjegjësiave të tyre janë fuqizuar në harmoni me mandatin e EULEX-it.

Treguesit kyç:

- Shkalla e zbatimit të marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.
- Bizneset e themeluara apo të përkrahura në Kosovën veriore.

*(2) Supozimet dhe kushtet*

Duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme për arritjen e rezultateve të mësipërme: Qeveria ndan burime të mjaftueshme për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialogun të ndërmjetësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës; Kosova fillon zbatimin e agjendës së saj për Kosovën veriore; gjendja e sigurisë në Kosovën veriore mundëson zbatimin e papenguar të projekteve; mandati i EULEX-it zbatohet në

funkcion të bartjes graduale të përgjegjësiave tek autoritetet relevante si dhe fuqizimin e pronësisë së tyre.

Dështimi në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara më lartë mund të shpie në kthimin e fondeve në bazë të këtij programi dhe/ose ri-alokimin e fondeve në të ardhmen.

### *(3) Marrëveshja për zbatimin e Veprimit: menaxhimi i drejtpërdrejtë*

#### *Elementet thelbësore të veprimit*

Varësisht nga nevojat në lidhje me zbatimin e objektivave dhe rezultateve të përcaktuara më lartë, përfshirë dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe mandatin e EULEX-it (në funksion të bartjes graduale të përgjegjësiave tek autoritetet relevante si dhe fuqizimin e pronësisë së tyre), masat e përshkruara më lartë do të zbatohen nëpërmjet një numri të kontratave të shërbimit/kornizë, si dhe kontratat e punës dhe furnizimit ku nevoja për reagim të shpejtë të Komisionit në ngjarjet jo të programueshme është e tillë sa që kohëzgjatja e procedurës për ndryshimin e këtij vendimi do të mund të pengonte qëllimin e përgjigjes së tillë. Zbatimi do të përfshijë:

Prokurimi: Ndarja e përgjithshme buxhetore e rezervuar për prokurim: 3,000,000 Euro

Numri i ndikativ dhe lloji i kontratës: 3 – 5 kontrata të shërbimit, 3-5 kontrata kornizë dhe 2-3 kontrata të furnizimit apo të punës.

Afati kohor i ndikativ për lansimin e procedurës së prokurimit: TM1 2017 – TM4 2019

SEKTORI 2	Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore		8 000 000 Euro
Veprimi 3	Mbështetje për të drejtat e komuniteteve në Kosovë	Menaxhimi indirekt me organizatën ndërkombëtare	8 000 000 Euro

*(1) Përshkrimi i veprimit, objektivit, rezultatit të pritshme dhe treguesit kyç të performancës*

Ky veprim do të kontribuojë në një shoqëri të qëndrueshme shumetnike në Kosovë duke mundësuar jetesë të qëndrueshme dhe integrim të qëndrueshëm të personave të zhvendosur në shoqërinë e Kosovës, përfshirë Personat e Zhvendosur Brenda Vendit (PZHBV), Personat e Zhvendosur në Rajon (PZHR-të) dhe refugjatët, siç përcaktohet në Strategjinë për Komunitete dhe Kthim (2014 - 2018). Në veçanti, ky veprim do të synojë ngritjen e kapaciteteve të akterëve publik dhe jo-qeveritarë për lehtësimin e kthimit dhe riintegrimin të dinjitetshëm dhe të qëndrueshëm të deri në 400 familjeve të zhvendosura në rajon në Kosovë, përfshirë familjet Rome, Ashkali dhe Egjiptas (RAE) që aktualisht jetojnë në vendbanime dhe kampe joformale në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Mal të Zi.

Rezultatet e pritura përfshijnë si në vijim: Kapaciteti i autoriteteve qendrore dhe komunale në lehtësimin e kthimit vullnetar dhe riintegrimin është përmirësuar; deri në 400 familje të kthyer në Kosovë; qëndrueshmëria e riintegrimin të familjeve të kthyer është përmirësuar nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së përshtatur socio-ekonomike; qasje më e madhe në dokumentet e gjendjes civile dhe shërbimet publike.

Treguesit kyç përfshijnë:

- Numrin e familjeve minoritare (të zhvendosura në rajon) që janë lehtësuar të kthehen dhe riintegrohen në Kosovë, të ndarë sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe moshës.
- Numrin e familjeve të komuniteteve RAE (të zhvendosur në kampe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Mal të Zi) të lehtësuar për t'u kthyer dhe riintegruar në Kosovë, të ndarë sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe moshës.

## *(2) Supozimet dhe kushtet*

Duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme nëse synohet arrija e rezultateve të mësipërme: Gjendja politike dhe e sigurisë mbetet e qëndrueshme për kthimin dhe riintegrimin e përfituesve; komunitetet pranuese demonstron një qëndrim pozitiv ndaj të kthyerve nga grupet minoritare; gatishmëria e akterëve relevant qendror dhe komunal, publik dhe jo-qeveritarë për të bashkëpunuar; - Autoritetet komunale ndajnë tokën publike për rastet e të kthyerve që nuk posedojnë tokë.

Dështimi në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara më lartë mund të shpie në kthimin e fondeve në bazë të këtij programi dhe/ose ri-alokimin e fondeve në të ardhmen

## *(3) Marrëveshja për zbatimin e Veprimin:*

**Menaxhimi indirekt – Pillar Assessed Delegation Agreement (PADA)**

*(3)(a) Entiteti që i janë besuar detyrat e zbatimit të buxhetit*

Veprimi zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM) për shkak të përvojës së tyre të konsiderueshme në sektor. IOM është partner afatgjatë i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) në Kosovë dhe i BE-së në fushën e të drejtave të komuniteteve minoritare. Përfshirja e IOM në këtë rast justifikohet më tej duke pasur parasysh:

(i) Përvojën dhe praninë e IOM-it në Kosovë dhe faktin që ata kanë zbatuar fondet e BE-së dhe programit të MKK në disa vitet e fundit në sektor [(i) Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë (RRK) sipas programeve IPA 2010 dhe IPA 2012; (ii) Programi për Stabilizim të Komuniteteve sipas IPA 2009, IPA 2011 dhe IPA 2014];

(ii) IOM-i (nën fazën e IV të projektit RRK të financuar nëpërmjet programit IPA 2012) ka marrë plotësisht procesin e lehtësimit të kthimit të familjeve të mbetura të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas të zhvendosura në kampet e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi;

(iii) Përfshirja e rritur e IOM-it në lehtësimin dhe mbështetjen e dialogut rajonal ndër-qeveritar ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, dhe

(iv) Bashkëpunimi i ngushtë i IOM-it me MKK dhe komunat përkatëse mbi të gjitha çështjet e kthimit, riintegrimin dhe stabilizimit të komuniteteve minoritare.

*(3)(b) Përshkrimi i shkurtër i detyrave që i janë besuar entitetit*

Ky veprim përbëhet nga disa aktivitete të ndryshme (qasja e ashtuquajtur shumë-sektoriale), ku të gjitha do të mund t'i besohen IOM-it: (i) lehtësimi i aktiviteteve para kthimit (vlerësimi i përfituesve dhe përzgjedhja përfundimtare), (ii) dialogu ndëretnik dhe aktivitete të pajtimit, (iii) ndërtimi i ndërtesave të banimit, (iv) lehtësimi i kthimit fizik, (v) qasja në shërbime sociale, përfshirë regjistrimin civil, arsimin dhe kujdesin shëndetësor, (vi) projektet përfshirëse zhvillimore të komunitetit, dhe (vii) aktivitetet për punësim dhe gjenerimin e të ardhurave.

Afati kohor indikativ për arritjen e matrëveshjes: TM2 2017.

SEKTORI 6	Konkurrueshmëria dhe inovacioni		10 000 000 Euro
Veprimi 4	Mbështetje për përmirësimin e konkurrueshmërisë së Kosovës	Menaxhimi indirekt me organizatën ndërkombëtare	5 000 000 Euro
		Menaxhimi i drejtpërdrejtë	5 000 000 Euro
		Gjithsej:	10 000 000 Euro

*(1) Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës*

Objektivi kryesor i veprimit është mbështetja e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të Kosovës (NMVM-ve dhe NVM-ve) në qasje në financa dhe njohuri teknike për të filluar/ritur bizneset e tyre dhe për të rritur konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tyre që qojnë në rritjen në outputin e N(M)VM dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Ky veprim do të përbëhet nga:

1. Lehtësimi kreditor dhe këshillues që duhet të zbatohet nga BERZH, përbëhet nga elementet në vijim:
  - a. Financimi afatgjatë për ndërmarrjet për të lehtësuar qasjen në financimin afatgjatë për investimet e kualifikueshme që do të përmirësojnë konkurrueshmërinë e NVM-ve. Financimi do të ofrohet nga kontributi i BERZH dhe do të kanalizohet tek NVM-të nëpërmjet bankave dhe institucioneve mikro-financiare në Kosovë, së bashku të referuara si Institucione Partnere Financiare (IPF-të);
  - b. Stimujt investues për ndërmarrjet për përzierjen e financimit të BERZH dhe investimeve të stimuluar nga NVM-të. Ky komponent do të financohet nga kontributi i Bashkimit Evropian (BE) nën IPA II;
  - c. Asistenca teknike për IPF-të për ngritjen e kapaciteteve të tyre, zhvillimin e sistemeve dhe mjeteve për ofrimin e shërbimeve të duhura dhe të dedikuara në mbështetje të



konkurrueshmërisë së NVM-ve. Ky komponent do të financohet nga kontributi i BE-së nën IPA II;

d. Shërbimet këshilluese për ndërmarrjet për të ofruar qasje në njohuritë teknike për ndërmarrjet, përfituesit e lehtësimit në mënyrë që të lehtësohet qasja në financa, mënyrën e biznesit të tyre dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së tyre. Ky komponent do të financohet nga kontributi i BE-së nën IPA II.

2. Granti që synon NMVM-të në 6 sektorë prioritar (përpunimi i drurit përfshirë mobiliet, TIK, tekstilet dhe përpunimin e lëkurës, punimet e metalit dhe përpunimin e metalit, shërbimet, turizmin) që duhet të zbatohen nga Zyra e BE-së në Kosovë.

Rezultatet e pritura përfshijnë qasje të përmirësuar në financa për ndërmarrjet mikro dhe NVM-të në Kosovë (veçanërisht gratë ndërmarrëse do të synohen nga veprimi).

Treguesit kyç përfshijnë:

- Vëllimin e investimeve nga NMVM-të në Kosovë.
- Numrin e NMVM-ve që pranojnë shërbime mbështetëse.
- Numrin e vendeve të reja të punës në kuadër të NMVM-ve të mbështetura.
- Shuma e përgjithshme e fondeve të ofruara tek NMVM-të e kualifikueshme

### *(2) Supozimet dhe kushtet*

Duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme për arritjen e rezultateve të mësipërme: kapaciteti absorbues i NMVM-ve: apetitet brenda NMVM-ve për zgjerim, nevoja për fonde; NMVM-të duhet të jenë në gjendje të përmbushin parakushtet e përcaktuara nga IPP-të për marrjen e kredive.

Dështimi në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara më lartë mund të shpie në kthimin e fondeve në bazë të këtij programi dhe / ose ri-alokimin e fondeve në të ardhmen.

### *(3) Marrëveshja për zbatimin e Veprimit:*

**Menaxhimi indirekt – Pillar Assessed Delegation Agreement (PADA)**

*Entiteti që i janë besuar detyrat e zbatimit të buxhetit*

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka përvojë të konsiderueshme në konkurrueshmërinë në sektor dhe në zbatimin e lehtësimeve të ngjashme. Gjatë periudhës 2011-2015, BERZH ka qenë

partner implementues në projektin e IPA 2008 për Lehtësimin për Financimin e Eficiencës së Energjisë në Kosovë, ku një nga përfituesit e drejtpërdrejtë ishte NVM-të. Gjatë periudhës 2010-2014, BERZH ishte partner implementues i projekteve 'Menaxhimi TurnAround' dhe 'Mbështetja Biznesore Këshilluese për NVM-të'.

Në këto veprime paraprahe, BERZH ka dëshmuar të jetë partner i besueshëm duke siguruar zbatimin e suksesshëm të projekteve, koordinimin e duhur dhe maksimizimin e burimeve.

Në bazë të përvojës paraprahe dhe në bazë të kapaciteteve teknike, pranisë rajonale, njohurisë mbi sektorin, zyrave dhe pajisjeve ekzistuese, është e rëndësishme që zbatimi i lehtësimeve kreditore dhe këshilluese zbatohet nga BERZH.

#### *Përshkrimi i shkurtër i detyrave që i janë besuar entitetit*

Lehtësimi kreditor dhe këshillues për NVM-të i zbatuar nga BERZH do të përbëhet nga elementet kyçe në vijim:

- (i) Stimujt Investues për Ndërmarrjet. Grantet për përzierje me financimin e BERZH dhe stimulimi i investimeve nga NVM-të;
- (ii) Asistenca teknike për IPP-të për ngritjen e kapaciteteve të tyre, zhvillimin e sistemeve dhe njetëve për ofrimin e shërbimeve të përshtatshme dhe të dedikuara në mbështetje të konkurrueshmërisë së NVM-ve;
- (iii) Shërbimet këshillimore për ndërmarrjet për të ofruar qasje në njohuritë teknike për ndërmarrjet, përfituesit e lehtësimit, në mënyrë që të lehtësohet qasja në financa, të rritet biznesi i tyre dhe të përmirësohet konkurrueshmëria e tyre.

#### *Elementet thelbësore për veprim (për menaxhimin e drejtpërdrejtë)*

##### **Grante – Thirrje për propozim: Granti për Ndërmarrjet**

Modaliteti i zbatimit të këtij aktiviteti është menaxhimi i drejtpërdrejtë nga Zyra e BE-së në Kosovë. Ky aktivitet do të sigurojë investimet kapitale intensive për NMVM-të kyçe në sektorët prioritar (përpunimi i drurit duke përfshirë teknologjinë e komunikimit (TIK), përpunimi i tekstilit dhe lëkurës, punime metalike dhe përpunimit të metaleve, shërbime, turizëm) për furnizuesit e tyre (qasja e zinxhirit të vlerës).

- a) Objektivat dhe rezultatet e parapara: Rritja e performancës, prodhimit, kapaciteteve të eksportit dhe shkallës së punësimit të ndërmarrjeve të përzgjedhura, duke ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë financiare;

- b) Kriteret thelbësore të kualifikimit: Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme të regjistruara në Kosovë e që veprojnë në sektorët e mëposhtëm: përpunimi i drurit duke përfshirë mobiliet, teknologji të informimit dhe komunikimit (TIK), përpunim të tekstilit dhe lëkurës, punimet nga metalet dhe përpunimi i metaleve, shërbime, turizëm;
- c) Kriteret thelbësore të për zgjedhjes: kapaciteti financiar dhe operacional i aplikantit;
- d) Kriteret thelbësore të aprovimit të propozimit janë rëndësia, efektiviteti dhe fizibiliteti, qëndrueshmëria dhe kosto-efektiviteti i veprimit.
- e) Shkalla maksimale e bashkë-financimit të BE-së: Shkalla maksimale e mundshme e bashkë-financimit të BE-së për grante sipas kësaj thirrje është 90% e kostos së pranueshme të veprimit;
- f) Shuma indikative e thirrjes: 5.0 milion Euro;
- g) Data indikative për lansimin e thirrjes për propozime: Q2 2017.

<b>SEKTORI</b> 7	<b>Arsimi, Punësimi dhe politikat sociale</b>		<b>17 000 000 Euro</b>
<b>Veprimi 5</b>	<b>Mbështetje për arsimin në Kosovë</b>	<b>Menaxhimi i drejtpërdrejtë</b>	<b>6 000 000 Euro</b>
		<b>Menaxhimi i drejtpërdrejtë përmes kontratës së grantit me një autoritet nga SHA</b>	<b>3 000 000 Euro</b>
		<b>Gjithsej:</b>	<b>9 000 000 Euro</b>

*(1) Përshkrimi i Veprimit, objektivit, rezultatit e pritshme dhe treguesit kyç të performancës*

Ky veprim synon të përmirësojë cilësinë e arsimit në Kosovë në të gjitha nivelet, me theks të veçantë në edukimin parashkollor, përfshirjen e fëmijëve që u përkasin komuniteteve pakicë dhe reformimin e administratës publike.

Rezultatet e pritshme përfshijnë: rritjen e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor nga të gjitha komunitetet, me theks të veçantë në grupet e rrezikuara siç janë ata nga zonat rurale dhe minoritetet;

rritja e numrit të mësimitdhënësve të aftësuar me qëllim përmirësimin e performancës së tyre; arritje të përmirësuara nga nxënësit në shkrimin-lexim dhe matematikë.

Për Skemën e Profesionistëve të Rinj, rezultati i pritur përfshin rritje në numrin e kandidatëve të përzgjedhur (të zgjedhur në bazë të mangësive në kapacitetet profesionale administrative të shërbimit civil të Kosovës), të cilët përfundojnë studimet pasuniversitare në universitetet e BE-së në fushat përkatëse dhe më pas punësohen në shërbimin civil.

Treguesit kyç tregojnë:

- Numrin e kopshteve të ndërtuara.
- Numrin e fëmijëve - duke përfshirë edhe fëmijët që i përkasin komuniteteve pakicë/grupeve të cenueshme - të moshës 0-5 të regjistruar në arsimin parashkollor.
- Numri i edukatorëve parashkollorë dhe mësimitdhënësve të arsimit fillor të trajnuar.
- Numri i përfutuesve të YCS të cilët janë punësuar.

## *(2) Supozimet dhe kushtet*

Kushtet e mëposhtme duhet të plotësohen për të arritur rezultatet e mësipërme: Komunitat në të cilat do të ndërtohen kopshte janë të gatshme dhe në gjendje të ndajnë burimet e njaltueshme për të siguruar mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë e projekteve të komunitetit; komunitat përkatëse ndajnë tokën dhe ofrojnë dokumentacionin teknik, leje si dhe qasje në infrastrukturën e duhur; mbështetje nga autoritetet lokale dhe qendrore; aktorët kryesorë nga të dy nivelet qendrore dhe lokale të qeverisjes janë mjaft të përfshirë në vlerësimin e nevojave në lidhje me përmirësimin e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve për të siguruar angazhimin e mësimitdhënësve dhe saktësinë e trajnimeve të ofruara.

Për Skemën e Profesionistëve të Rinj; Interesi i universiteteve të BE-së në përfshirjen në procesin e përzgjedhjes; Kandidatët nuk do të tërhiqen pas përzgjedhjes, koordinimi ndërmjet Ministrisë së Integritimit Evropian dhe të gjitha institucioneve të linjës është funksional; mosdorëheqja e të diplomuarve nga shërbimi civil i Kosovës.

Mos-përputhja me kërkesat e përcaktuara më lartë mund të çojnë në kthimin e fondeve sipas këtij programi dhe/ose ri-afokimin e fondeve në të ardhmen.

## *(3) Marrëveshje për zbatimin e veprimit:*

### *Elementet thelbësore të veprimit (për menaxhimin e drejtpërdrejtë)*

**Granti - Dhënia e drejtpërdrejtë e grantit (Skema e Profesionistëve të Rinj)**

a) Objektivat dhe rezultatet e parapara:

Si objektiv është gjenerimi i një grupi bazë të nëpunësve civilë në fushat e identifikuara si të dobëta për Kosovën, të cilat do të iniciojnë reformat e nevojshme për zbatimin e MSA-së. Rezultatet e pritshme janë që kandidatët e zgjedhur (të zgjedhur në bazë të mangësive kapaciteteve profesionale administrative në shërbimin civil të Kosovës) të cilët kanë diploma të plota pasuniversitare në universitetet e BE-së në fushat përkatëse teknike dhe më pas punësohen në shërbimin civil.

b) Arsyetimi për përdorimin e përjashtimit të thirrjeve për propozime:

Neni 100 i ER RAP (I): për veprimet me karakteristika specifike që kërkojnë një lloj të veçantë të organit për shkak të kompetencave të saj teknike, shkallën e lartë të specializimit ose fuqisë së saj administrative, me kusht që veprimet në fjalë nuk bien në kuadër të thirrjes për propozime.

Ky aktivitet do të zbatohet përmes dhënies së drejtpërdrejtë të grantit për Këshillin Britanik si subjekti më i përshtatshëm për të zbatuar projektin për shkak të ekspertizës së saj të konsiderueshme administrative dhe teknike dhe kapaciteteve në drejtimin e skemave për bursa. Këshilli Britanik ka vepruar si partner afat-gjatë i Ministrisë së Integrimit Evropian (MIE) dhe Zyrës së BE-së për programin e bursave për Skemën e Profesionistëve të Rinj.

YCS është i vetmi program i bursave në Kosovë që ofron mundësinë/detyron marrësit e granteve me një kontratë pune 3-vjeçare në administratën publike të Kosovës pas kthimit të tyre nga kryerja e studimeve master jashtë vendit. Deri në 10% e bursave do të ndahet për nëpunësit ekzistues civilë. Skema lejon administratën publike të Kosovës të marrë ekspertizë relevante në fushën e administratës publike, ligjit dhe ekonomisë dhe ndihmon të mbajë të diplomuarit më të mirë në Kosovë.

Këshilli Britanik ka përvojë në drejtimin e programit YCS në tri rraundet e kaluara të njëpasnjëshme (Raundi X në vitin 2012/13, Raundi IXA në vitin 2014/15, dhe Raundi X në vitin 2015/16) dhe ka avantazhin e pranisë fizike dhe përvojës operative në Kosovë (zyrën, stafin i përlirshëm, ekspertë të shumtë, koordinimi i rregullt me zyrtarët e shërbimit civil në krye të programit YCS). Reputacioni global i Këshillit Britanik dhe rrjeti i gjerë i universiteteve partnere që kanë përvojë me përfituesit e YCS kanë mundësuar që programi të jetë në gjendje të sigurojë zbritje në tarifën e regjistrimit, në rraundin e 10-të, me universitete të caktuara të BE-së, ndërsa disa universitete të BE-së gjithashtu kanë ranë dakord të zgjatën afatet e tyre për regjistrimin e studentëve ekskluzivisht për programin YCS (edhe pse afatet zyrtare tashmë kanë kaluar).

c) Emri i përfituesit: Këshilli britanik

d) Kriteret thelbësore të përzgjedhjes janë kapaciteti financiar dhe operacional i aplikantit.

- e) Kriteret e aprovimit të propozimit janë rëndësia, efektiviteti dhe fizibiliteti, qëndrueshmëria dhe kosto-efektiviteti i veprimit.
- f) Shuma indikative e grantit: 3.0 milion Euro
- g) Shkalla maksimale e bashkë-financimit të BE-së: për grante nën këtë thirrje është 75% e koston së pranueshme të veprimit.

Norma maksimale e mundshme e financimit të BE-së mund të jetë deri në 100% e koston totale të veprimit në përputhje me nenin 192 të Rregullores Financiare, nëse për vënien në zbatim të veprimit duhet financimi i plotë. Nevoja për financim të plotë nga ana e BE-së do të justifikohet nga zyrtari autorizues përgjegjës në vendimin për dhënie e grantit, në lidhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar.

- h) Periudha kohore indikative për lidhjen e marrëveshjes për grant: Q2 2017.

**Prokurimi:**

- a) ndarja e përgjithshme buxhetore e rezervuar për prokurim: 6.0 milion Euro
- b) Numri indikativ dhe lloji i kontratës:

Do të ketë: 1 kontratë e punimeve për aktivitetin 1: Mbështetja e përmirësimit të infrastrukturës së arsimit, dhe 1 kontratë për shërbime për aktivitetin 2: Ngritja e përmirësuar e kapaciteteve për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve.

- c) Korniza kohore indikative për lansimin e procedurës së prokurimit: Q1 2017

<b>SEKTORI 7</b>	<b>Arsimi, punësimi dhe politikat sociale</b>		<b>17 000 000 Euro</b>
<b>Veprimi 6</b>	<b>Zbatimi i masave aktive të tregut të punës dhe mbështetja e lufës kundër punës së</b>	<b>Menaxhimi i drejtpërdrejtë</b>	<b>8 000 000 Euro</b>

	padeklaruar		
--	-------------	--	--

*(a) Përshkrimi i veprimit, objektivat, rezultatet e pritura dhe indikatorët kyç të performancës.*

Objektivat kryesore të veprimit janë rritja e punësimit dhe përfshirja sociale e të rinjve dhe grave dhe fuqizimi i kapaciteteve njerëzore të institucioneve përfituese në mënyrë që të reduktohet puna e padeklaruar duke rritur punësimin dhe perspektivën e punësimit të qëndrueshëm për grupet e pa-favorizuara.

Rezultatet e pritura përfshijnë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është e gatshme të hartoj, zbatoj dhe monitoroj masat aktive të tregut të punës, duke u fokusuar në grupet e pa-favorizuara, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë; ngritja e kapacitetit të Inspektoratit të Punës dhe partnerëve social relevant; ngritja e vetëdijes në lidhje me luftën kundër punës së padeklaruar.

Indikatorët kyç:

- Shkalla e papunësisë (gjithsej, meshkuj, femra, persona më të rinj se 25).
- Shkalla e varfërisë
- Numri i punëtorëve të deklaruar

*(b) Supozimet dhe kushtet*

Duhet të përmbushen kushtet në vijim në mënyrë që të mundësohet arritja e rezultateve të parapara: Ekziston angazhim i vazhdueshëm politik për realizimin e strategjive të përshtatshme lokalisht dhe Masat Aktive të Tregut të Punës (MATP) në Kosovë. Shkalla e krijimit të vendeve të punës është në nivelin e njëjtë si në vitin 2015, ose ka pasur rritje; niveli i financimit për MATP është i njëjtë ose do të rritet; vullneti politik për të përmirësuar nivelet aktuale të punës së padeklaruar; angazhimi i Qeverisë për vazhdimin e procesit të reformës dhe luftimin e punës së padeklaruar.

Mos përputhja me kërkesat e paraqitura më lart mund të qoj në kthimin e fondeve sipas këtij programi dhe/ose ri-alokimin e fondeve.

*(3) Marrëveshja për zbatimin e veprimit: menaxhimi i drejtpërdrejtë*

*Elementet thelbësore për veprimin*

**Prokurimi:**

- a) ndarja e përgjithshme buxhetore e rezervuar për prokurimin; 2.0 milion Euro

- b) numri i ndikativ dhe Hoji i kontratave: 2 kontrata të shërbimit
- c) Korniza kohore i ndikativ për lansimin e procedurës së prokurimit: Q2 2017

*Grante – Thirrja për propozime I: Mbështetja për Aftësim Profesional dhe Trajnim në Vendi e Punës, Vetë-punësim dhe Ndërmarrësi.*

- a) Objektivat dhe rezultatet e parapara: Krijta e punësueshmërisë së grave dhe të rinjve
- b) Kriteret thelbësore të përzgjedhjes:
  - a. Aplikantët: Zyrat e punësimit, Shkollat profesionale, Qendrat e ekscelencës, Qendrat e Aftësimi Profesional, shoqatat dhe fondacionet e shoqërisë civile.
  - b. Llojet e veprimit: trajnimi dhe ri-trajnimi i shënjestruar tek gratë dhe të rinjtë; me qëllim të ndërmarrësisë dhe vetë-punësimit.
- c) Kriteret thelbësore të përzgjedhjes janë kapacitete financiare dhe operative të aplikantit.
- d) Kriteret thelbësore të aprovimit të propozimit janë rëndësia, efektiviteti dhe fizibiliteti, qëndrueshmëria dhe kosto-efektiviteti i veprimit.
- e) Shkalla maksimale e bashkë-financimit të BE-së: Shkalla maksimale e mundshme e bashkë-financimit të BE-së për grante sipas kësaj thirrje është 95% e koston së pranueshme të veprimit.
- f) Shuma i ndikativ e thirrjes: 4.0 milion Euro
- g) Data i ndikativ për lansimin e thirrjes për propozime: Q3 2017

*Grante – Thirrja për propozime II: Mbështetje për punëdhënësit e grupeve të pa-favorizuara, veçanërisht gratë dhe të rinjtë si dhe mbështetja për udhërrëfjet sociale.*

- a) Objektivat dhe rezultatet e parapara: Krijta e punësimit përmes financimit të aktiviteteve të ndërtydhura me punën e punëdhënëseve dhe udhërrëfjet sociale
- b) Kriteret thelbësore të përzgjedhjes:
  - a. Aplikantët: udhërrëfjet të cilat krijojnë punë dhe udhërrëfjet shoqërore.
  - b. Llojet e Veprimeve: Mbështetja e investimeve për aktivitetet e zgjerimit të biznesit (ndërtimi, pajisjet, materialet etj.); mbështetje teknike për marketingun, standardet, subvencionet e përkohshme për pagat duke punësuar persona të disavantazuar; etj.
- c) Kriteret thelbësore të përzgjedhjes janë kapacitetet financiare dhe operative të aplikantit.
- d) Kriteret thelbësore të aprovimit të propozimit janë rëndësia, efektiviteti dhe fizibiliteti, qëndrueshmëria dhe kosto-efektiviteti i veprimit.
- e) Shkalla maksimale e bashkë-financimit të BE-së: Shkalla maksimale e mundshme e bashkë-financimit të BE-së për grante sipas kësaj thirrje është 95% e koston së pranueshme të veprimit.
- f) Shuma i ndikativ e thirrjes: 2.0 milion Euro



g) Data indikative për lansimin e turrës për propozime: Q1 2018

3 BUXHETI

3.1 TABELA INDIKATIVE E BUXHETIT – PROGRAMI I VEPRIMIT PËR KOSOVËN

Mënyshimi i drejtëdrejtë						
		Kontributi i BE-së	Bashkëfinancimi nga përfituesi IPA II	Sipërçimet e përgjithshme	MM	
	Sektori 1 Demokracia dhe qeverisja	10 500 000 Euro		10 500 000 Euro	drejtëdrejtë	
	Veprimi 1 Lehtësimi i përafritimit me Acquis të BE	7 500 000 Euro		7 500 000 Euro	drejtëdrejtë	
Objektivi 1	Veprimi 2 Lehtësimi i jetësimit të prioritetëve politike, duke përfshirë dialogun e ndërmjetësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës	5 000 000 Euro		5 000 000 Euro	drejtëdrejtë	
	Sektori 2 Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore	8 000 000 Euro	2 750 000 Euro	10 750 000 Euro	Indirekte me IO	
	Veprimi 3 Mbështetje për të Drejtat e Komuniteteve në Kosovë	8 000 000 Euro	2 750 000 Euro	10 750 000 Euro	Indirekte me IO	
Buxheti i përgjithshëm për objektivin 1- linja buxhetore 22.02.01.01		18 500 000 Euro	2 750 000 Euro	21 250 000 Euro	përzier	
	Sektori 6 Konkurrenca dhe inovacioni	10 000 000 Euro	20 500 000 Euro	30 500 000 Euro	përzier	
Objektivi 2	Veprimi 4 "Mbështetje për krijimin e konkurrencës në Kosovë"	10 000 000 Euro	20 500 000 Euro	30 500 000 Euro	Përzier (drejtëdrejtë- indirekt me IO)	
	Sektori 7 Arsimi, Punësimi dhe politikat sociale	17 000 000 Euro	2 400 000 Euro	19 400 000 Euro	drejtëdrejtë	
	Veprimi 5 "Mbështetje për Arsimin në Kosovë"	9 000 000 Euro	2 000 000 Euro	11 000 000 Euro	drejtëdrejtë	

	Veprimi 6 "Zbatimi i masave aktive të tregut të punës dhe mbështetja e luftës kundër punës së padeklaruar"	8 000 000 Euro	400 000 Euro	8 400 000 Euro	drejtpërdrejtë
Buxheti i përgjithshëm për objektivin 2 – linja buxhetore 22.02 01 02		27 000 000 Euro	22 900 000 Euro	49 900 000 Euro	përzier
GJITHSEJ		45 500 000 Euro	25 650 000 Euro	71 150 000 Euro	përzier

#### 4 MODALITETET E ZBATIMIT DHE REGULLAT E PËRGJITHSHME PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT DHE NDARJES SË GRANTEVE

##### **MENAXHIMI DIREKT:**

Ky program do të zbatohet nëpërmjet menaxhimit direkt nga Zyra e BE-së në përputhje me nenin 58 (1) (a) të Rregullores Financiare dhe dispozitat e tij përkatëse për Rregullat e Zbatimit.

Prokurimi duhet të respektoj dispozitat e Pjesës së Dytë, Titullit IV, Kapitullit 3 të Rregullores Financiare Nr. 966/2012 dhe Pjesës Dy, Titullit II, Kapitullit 3 të rregullave të saj të zbatimit.

Procedurat e dhënies së grantit duhet të respektojnë dispozitat e Pjesës Dy, Titullit IV, Kapitulli 4 të Rregullores Financiare Nr. 966/2012 dhe Pjesës II, Titullit II, Kapitullit 4 të rregullave të saj të zbatimit.

Sipas Rregullores Financiare Pjesa Një dhe Tre e Rregullores Financiare zbatohet për veprimet e jashtme, përveç kur parashikohet ndryshe në Pjesën II, Titullin IV .

Komisioni mund të përdorë gjithashtu edhe shërbimet dhe furnizimet nga Kontratat e saj Kornizë të arritura në përputhje me Pjesën Një të Rregullores Financiare..

##### **Binjakëzimi:**

Projektet e Binjakëzimit organizohen në formë të marrëveshjeve për grante, përmes së cilave administratat e përzgjedhura të Shteteve Anëtare pajtohen për ofrimin e ekspertizës së kërkuar të sektorit publik kundrejt rimbursimit të shpenzimeve të shkaktuara me këtë rast.

Kontrata mund të parasheh në veçanti delegimin afatgjatë të një zyrtari të caktuar për ofrimin e këshillave me orar të plotë për administratën e përlituesit të IPA II si këshilltar rezident i binjakëzimit.

Marrëveshja e grantit të binjakëzimit përcaktohet në përputhje me dispozitat relevante të Pjesës Dy, Titulli IV, Kapitulli 4 i Rregullores Financiare dhe Pjesa Dy, Titulli II, Kapitulli 4 i Rregullave të tij të Aplikimit. Pjesët Një dhe Tre të Rregullores Financiare zbatohen për veprimet e jashtme, përveç nëse parashihet ndryshe në Pjesën Dy, Titulli IV.

##### **MENAXHIMI INDIREKT**

Një pjesë e këtij programi do të zbatohet nga menaxhmenti indirekt me subjektet që i janë besuar, përveç përfituesve të IPA II, në përputhje me nenin 58 (1) (c) të Rregullores Financiare dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së Zbatimit.

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT DHE DHËNIES SË GRANTIT DO TË PËRCAKTOHEN NË MARRËVESHJEN E FINANCIMIT DHE MARRËVESHJEVE PËRKATËSE TË DELEGACIONIT NDËRMJET KOMISIONIT DHE SUBJEKTIT TË BESUAR I CILI ZBATON VEPRIMIN E TËLË.

#### 5 ARANZHIMET PËR MONITORIMIN E PERFORMANCËS

Si pjesë e kornizës së saj për matjen e performancës, Komisioni do të monitorojë dhe vlerësojë progresin kundrejt arritjes së objektivave specifike të përcaktuara në Rregulloren e IPA II në bazë të treguesve të paracaktuar, të qartë, transparent dhe të matshëm. Raportet e progresit të referuara në nenin 4 të Rregullores së IPA II duhet të merren si pikë referimi në vlerësimin e rezultateve të asistencës së IPA I.

Komisioni do të mbledhë të dhënat e performancës (procesit, treguesit e outputit dhe rezultateve (outcome) nga të gjitha burimet, të cilat do të grupohen dhe analizohen në aspektin e përcjelljes së progresit kundrejt objektivave dhe kritereve të përcaktuara për secilin nga veprimet e këtij programi, si dhe Dokumenteve Strategjike Indikative për Kosovën.

Progresi i përgjithshëm do të monitorohet përmes mjeteve të mëposhtme: a) Sistemi i Monitorimit i Orientuar në Rezultate (ROM); b) vet-monitorimet e përfituesve të IPA II; c) vetë-monitorimi i kryer nga Delegacionet e BE-së; d) monitorimi i përbashkët nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim dhe Negociata dhe përfituesit e IPA II, ku pajtueshmëria, koherenca, efektiviteti, efikasiteti dhe koordinimi për zbatimin e asistencës financiare do të monitorohen rregullisht nga një komitet për monitorimin e IPA II, mbështetur nga Komiteti i përbashkët për Monitorim, i cili do të sigurojë një proces të monitorimit në nivel të programit.

Për përfituesin e IPA II:

Z. Besnik Bislimi  
Zëvendëskryeministër i parë, për integrim  
evropian, dialog dhe zhvillim  
Zyra e Kryeministrit  
10000 Prishtinë, Kosovë

Për Komisionin:

Znj. Michela Matuella  
Drejtoreshë D -- Ballkani Perëndimor  
Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociata  
për Zgjerim  
Komisioni Evropian  
B-1049 Bruksel, Belgjikë